



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.143**

**27 tetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |      |
|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.765, datë 24.9.2010 | Për një shtesë në vendimin nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar ..... | 7719 |
| Vendim i KM<br>nr.766, datë 24.9.2010 | Për rishpërndarje fondesh, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për shpenzime korente, ndërmjet programeve .....                                                                                                                                                     | 7719 |
| Vendim i KM<br>nr.767, datë 24.9.2010 | Për një shtesë në vendimin nr.228, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për dietat e nëpunësve, që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, të ndryshuar .....                                                                                                                                 | 7720 |
| Vendim i KM<br>nr.768, datë 24.9.2010 | Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Hajmel, të qarkut të Shkodrës .....                                                                                                                                                                                    | 7720 |
| Vendim i KM<br>nr.769, datë 24.9.2010 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit .....                                                                                                                              | 7721 |
| Vendim i KM<br>nr.770, datë 24.9.2010 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Roskovec, të qarkut të Fierit .....                                                                                                                               | 7722 |
| Vendim i KM<br>nr.771, datë 24.9.2010 | Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar .....                                                                                                                                                        | 7723 |
| Vendim i KM<br>nr.772, datë 24.9.2010 | Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit .....                                                                                                                                                                                                                                                  | 7723 |

|                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |      |
|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.775, datë 24.9.2010 | Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë .....                                                                                                                                                                                                                                            | 7724 |
| Vendim i KM<br>nr.776, datë 24.9.2010 | Për caktimin e shpërblimit të kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil .....                                                                                                                                                                                              | 7727 |
| Vendim i KM<br>nr.777, datë 24.9.2010 | Për miratimin e rregullave për kryerjen e inspektimit, çështjet, metodologjinë, frekuencat e për mënyrën e njoftimit dhe të procedurave që ndjek administratori për zbatimin e tyre.....                                                                                                                             | 7727 |
| Vendim i KM<br>nr.778, datë 24.9.2010 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë arë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass, Plepa-Kavajë - Rrogozhinë, lotet 9, 10, 11 e 12” .....                                                                                                   | 7730 |
| Vendim i KM<br>nr.779, datë 24.9.2010 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore, Korçë (dritat e verdha, kryqëzimi Korçë - Kapshticë)” .....                                                                   | 7732 |
| Vendim i KM<br>nr.781, datë 29.9.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.513, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV, Tiranë-Podgoricë, qarku Durrës” .....                                                        | 7739 |
| Vendim i KM<br>nr.782, datë 29.9.2010 | Për disa shtesa në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar .....                                                                                                                                                               | 7741 |
| Vendim i KM<br>nr.783, datë 29.9.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar .....                                                                                 | 7742 |
| Vendim i KM<br>nr.784, datë 29.9.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar ..... | 7745 |
| Vendim i KM<br>nr.785, datë 29.9.2010 | Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, kopsht “École française, Jules Verne” .....                                                                                                                                                                                           | 7748 |
| Vendim i KM<br>nr.786, datë 29.9.2010 | Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2010-2011 .....                                                                                                                                 | 7748 |
| Udhëzim i MF<br>nr.34, datë 6.10.2010 | Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar .....                                                                                                                                                                               | 7754 |

**VENDIM**  
**Nr.765, datë 24.9.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDASHME PËR KRYERJEN E**  
**PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË**  
**KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA**  
**MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 20.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për arredimin me pajisje elektronike dhe orendi të Akademisë Tatimore e Doganore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.766, datë 24.9.2010**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR**  
**PËR KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË, PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET**  
**PROGRAMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rishpërndarjen e fondeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit për vitin 2010, t’i shtohet fondi 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë.

b) Programit të veprimtarisë mbikëqyrëse të KLD-së, për vitin 2010, t’i pakësohet fondi 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.767, datë 24.9.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.228, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DIETAT E NËPUNËSVE, QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË**  
**VENDBANIMIT TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të pikës 6 të vendimit nr.228, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshihet, efektivave të Gardës së Republikës u paguhet dietë edhe kur shërbimi kryhet në zona me largësi deri në 100 km nga qendra e punës, por që, për natyrë të veçantë shërbimi, nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Gardën e Republikës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 qershor 2010.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.768, datë 24.9.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME**  
**SHTETËRORE, NË KOMUNËN HAJMEL, TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Hajmel, të qarkut të Shkodrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 447 (katërqind e dyzet e shtatë).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.769, datë 24.9.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BAJRAM CURRI, TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.12, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Bajram Curri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Bashkia Bajram Curri

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                                                                        | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 1                                                       | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.                                                    | Në pronësi                  |
| 14-19,21                                                | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pasuria me nr.21 është në katin përdhe të një pallati pesëkatësh). | Në pronësi                  |
| 38-51,53,54                                             | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.                                                           | Në pronësi                  |
| 56,57                                                   | Prona që përdoren për shërbime sociale.                                                                                    | Në pronësi                  |
| 58-67                                                   | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                                               | Në pronësi                  |
| 68-69                                                   | Varreza publike                                                                                                            | Në pronësi                  |
| 81-82                                                   | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.                                                        | Në pronësi                  |
| 22,23,84-91,92-95,100                                   | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)                                                      | Në pronësi                  |
| 99                                                      | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji                                | Në përdorim                 |
| 104                                                     | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.                                             | Në pronësi                  |
| 125-128                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                     | Në përdorim                 |
| 129,130                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive).                   | Në pronësi                  |

**VENDIM**  
**Nr.770, datë 24.9.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË  
BASHKISË ROSKOVEC, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Roskovec, të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 34 (tridhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Bashkia Roskovec

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                                                                 | Lloji i transferimit |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 1-4                                              | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                                                      | Në pronësi           |
| 5-13                                             | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                                                 | Në pronësi           |
| 14-19,60-82,84,85,87-123,158                     | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.                                              | Në pronësi           |
| 20,20/1,21                                       | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.                                                 | Në pronësi           |
| 22                                               | Varrezat publike                                                                                                             | Në pronësi           |
| 23,24-28 (vetëm hapësirat publike) 159-161       | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)                                                        | Në pronësi           |
| 24-28 (vetëm trojet)                             | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji                                  | Në përdorim          |
| 30-49                                            | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit, mbrojtjes civile.                                      | Në pronësi           |
| 50                                               | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.                                           | Në pronësi           |
| 51                                               | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.                                                  | Në pronësi           |
| 55,57                                            | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                       | Në përdorim          |
| 56,58,134,148,151,156                            | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi           |

**VENDIM**  
**Nr.771, datë 24.9.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për blerjen dhe montimin e sistemit të pajisjeve për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe për lidhjen e kontratës përkatëse.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.772, datë 24.9.2010**

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES NDËRKOMBËTARE TË SHËNDETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.10 138 datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Instituti i Shëndetit Publik është institucioni kryesor kombëtar, përgjegjës për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (RRNSH), si dhe institucioni që raporton e informon Ministrinë e Shëndetësisë e Organizatën Botërore të Shëndetësisë për çdo ngjarje të pazakontë, të përcaktuar në rregullore.

2. Instituti i Shëndetit Publik ndjek dhe udhëheq zbatimin e detyrimeve të institucioneve, që rrjedhin nga Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit.

3. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë autoritetet përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, brenda juridiksionit përkatës, në çdo pikë hyrje të territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe institucionet e tjera, që kanë detyrime dhe përgjegjësi në veprimtarinë e tyre, në pikat hyrëse në vend.

4. Instituti i Shëndetit Publik bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me institucionet, që janë autoritete përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet, autoritete përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, që të fillojnë menjëherë dhe brenda 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i këtij vendimi, të përfundojnë marrjen e masave për zhvillimin, forcimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të domosdoshme për të zbuluar, vlerësuar, njoftuar e raportuar ngjarjet shëndetësore në përputhje me RRNSH-në dhe për t'u përgjigjur rreziqeve e emergjencave të shëndetit publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.775, datë 24.9.2010**

**PËR ADMINISTRIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 39 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 26 të ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Sigurimi dhe administrimi i financimeve të huaja, si pjesë përbërëse dhe/ose e raportuar në sistemin buxhetor të Republikës së Shqipërisë, është objekt i këtij vendimi.

2. Financime të huaja janë të gjitha huat, kreditë dhe grantet që merr Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë nga shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, organizatat joqeveritare etj.

3. Marrëveshje qeveritare kuadër janë marrëveshjet/protokollet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e bashkëpunimit financiar apo bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve.

4. Marrëveshje qeveritare janë marrëveshjet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e financimit të projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.

5. Marrëveshje financimi janë marrëveshjet e huas/kredisë apo grantit që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kreditorëve ose donatorëve të huaj, për financimin e projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.

6. Mbështetur në analizën dhe vlerësimin e situatës ekonomike e financiare të vendit, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave, miraton çdo vit programin buxhetor afatmesëm (PBA), si pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar (SPI). Programi buxhetor afatmesëm parashikon tërësinë e projekteve të investimeve publike, përfshirë edhe ato me financime tërësisht të huaja ose bashkëfinansim me buxhetin e shtetit, për çdo program, në një periudhë trevjeçare.

7. Koordinimi i projekteve me financim të huaj bëhet në përputhje me procedurat e sistemit të planifikimit të integruar (SPI), miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave. SPI-ja është kuadri kryesor kombëtar për hartimin e politikave dhe planifikimin financiar, përcaktimin e përparësive strategjike të zhvillimit dhe integritit të vendit dhe alokimin e burimeve të brendshme e financimeve të huaja, në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar.

8. SPI-ja, nëpërmjet kuadrit strategjik, në bazë të të cilit përcaktohen përparësitë për financim të huaj, bazohet në përparësitë e programit të qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, të përditësuar, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe planit kombëtar për zbatimin e MSA-së.

9. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe



Ministrinë e Integritetit, koordinon procesin e identifikimit, diskutimit dhe përzgjedhjes së përparësive strategjike duke u këshilluar me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore të pavarura.

10. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përmes mekanizmave dhe procedurave të përcaktuara në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), orienton programet afatgjata dhe afatmesme të financimeve të huaja dhe miraton listën e projekteve të reja parësore, për çdo sektor. Lista e projekteve parësore, e miratuar në parim, nga KPS-ja, do të përdoret në vijimësi nga Ministria e Financave dhe DEBASKON-i, në negociatat me huadhënësit/dhuruesit, për financime të reja.

11. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që ka të drejtë të kërkojë dhe të sigurojë financime nga huadhënësit dhe dhuruesit, në formën e huave dhe granteve, që janë bashkëfinancim me hua. Në rastet e sigurimit të financimeve vetëm me grant ose kur granti është bashkëfinancim me fonde buxhetore, ky proces kryhet nga DEBASKON-i në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritetit.

12. Përgjegjësitë e institucioneve për ndjekjen e procedurave për përfundimin e marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, janë si vijon:

a) Për marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit, Ministria e Financave dhe DEBASKON-i janë, përkatësisht, palë kryesore në negociatë, në varësi të llojit të financimit, me hua apo grant. Në grupin e negocimit marrin pjesë edhe përfaqësues të ministrive përkatëse të linjës.

b) Për marrëveshjet qeveritare, procesi i negocimit udhëhiqet nga DEBASKON-i, i cili bashkëpunon me ministritë e linjës dhe Ministrinë e Financave. Nga kjo pikë bën përjashtim negocimi i financimeve nga Programi i Asistencës së Paraaderimit (IPA) nga BE-ja, proces, i cili udhëhiqet nga Ministria e Integritetit.

c) Pas negocimit, Ministria e Financave në bashkëpunim me DEBASKON-in, paraqesin për miratim në parim në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare kuadër të negociuara.

ç) Pas negocimit, ministritë e linjës përfituese, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, paraqesin për miratim në parim, në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare dhe marrëveshjet e financimit të negociuara.

d) Ministri i Financave, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruan marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit.

dh) Ministrat përkatës të linjës, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruajnë marrëveshjet qeveritare.

13. Institucionet përfituese (qendrore dhe vendore), janë përgjegjëse për të parashikuar në buxhetin e tyre të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse të financimit, të miratuara.

14. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, institucioni nënshkruar ndjek procedurat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve përkatëse.

15. Ministria e Financave dhe DEBASKON-i shkëmbejnë informacionin me huadhënësit/dhuruesit dhe përfituesit e financimeve të huaja lidhur me huat/grantet e marra, masën dhe destinacionin e përdorimit të tyre.

16. DEBASKON-i dhe Ministria e Financave mbikëqyrin ministritë e linjës, për përmbushjen e kushteve të vendosura në marrëveshjet me huadhënësit dhe/ose dhuruesit dhe për progresin e bërë në zbatimin e projekteve përkatëse.

17. Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat dhe grantet. Ministritë dhe institucionet qendrore e vendore janë të detyruara t’i raportojnë Ministrisë së Financave të gjitha të dhënat e kërkuara, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave dhe granteve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor.

18. Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuruesi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave.

19. Shpenzimi i huave dhe granteve të livruara do të regjistrohet në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Transferimet në llogaritë e përfituesve kryhen nga llogaritë e sistemit të thesarit në bankat e nivelit të dytë. Kur huat dhe grantet livrohen në natyrë ose menaxhohen drejtpërdrejt nga dhuruesit, të regjistrohen në të njëjtën kohë si të ardhura (të hyra) në buxhet dhe si shpenzime (të dala), në bazë të njoftimit të pagesave të kryera për blerjen e mallrave ose shërbimeve përkatëse dhe konfirmimit të përfituesit.

20. Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mosraportimi në kohë ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfituar.

21. Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.

22. Brenda muajit janar dhe korrik të çdo viti, ministritë e linjës i raportojnë DEBASKON-it për:

- a) të dhënat për ecurinë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, për vitin pararendës;
- b) të dhënat për planifikimin e zbatimit të projekteve me financime të huaja, për vitin në vazhdim. Kjo përfshin si projektet që kanë filluar në vitin pararendës, ashtu edhe ato për të cilat financimi është i garantuar dhe zbatimi i tyre pritet të fillojë gjatë vitit në vazhdim;
- c) projektpropozimet për financime të huaja, për projekte që mund të diskutohen në negociatat me donatorët, gjatë vitit në vazhdim.

Për të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, ministritë e linjës informojnë edhe Ministrinë e Integritit, për projektet me mbështetje financiare nga fondet e BE-së.

23. DEBASKON-i, si njësi përgjegjëse e ngarkuar me mbajtjen e bazës së të dhënave të financimeve të huaja:

- a) përditëson bazën e të dhënave me informacionin e ardhur nga ministritë e linjës brenda muajit mars dhe muajit shtator të çdo viti;
- b) përgatit raportin vjetor të monitorimit të financimeve të huaja, për vitin pararendës.

24. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme lidhur me procedurat që duhen ndjekur gjatë fazave të ndryshme të livrimit, shpenzimit, raportimit dhe shlyerjes së kredive dhe granteve.

25. Ngarkohen Ministria e Financave, DEBASKON-i, Ministria e Integritit dhe ministritë e linjës, si dhe institucionet e tjera në varësi të pushtetit ekzekutiv qendror për zbatimin e këtij vendimi.

26. Vendimi nr.116, datë 24.2.1997 i Këshillit të Ministrave “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe granteve të huaja, që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.776, datë 24.9.2010**

**PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, të shpërblehen, përkatësisht, në masën 30% dhe 20%, të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.

2. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga mbledhja e parë e këshillit drejtues.

3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.777, datë 24.9.2010**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT, ÇËSHTJET, METODOLOGJINË, FREKUENCAT E PËR MËNYRËN E NJOFTIMIT DHE TË PROCEDURAVE QË NDJEK ADMINISTRATORI PËR ZBATIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 37, pika 4 e 46, pika 1 të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i çështjeve që janë subjekt i inspektimeve, i rregullave, i metodologjisë, i frekuencave dhe i mënyrës së njoftimit për kryerjen e inspektimeve, lënien e detyrave e caktimin e afateve kohore, si dhe i procedurave që ndjek administratori për zbatimin e tyre.

2. Qëllimi i inspektimit është kontrolli i kushteve të përgjithshme të ndërtesës, identifikimi dhe zbulimi i defekteve e mangësive të sistemeve të kontrolluara dhe të elementeve të tjera që ekzistojnë në kohën e kontrollit, të cilat janë të dukshme dhe mund të konstatohen gjatë kryerjes së procedurës së inspektimit.

3. Inspektimi i përditshëm i gjendjes së pronës dhe objekteve në bashkëpronësi kryhet nga administratori, i cili është përgjegjës për respektimin e rregullores së administrimit të bashkëpronësisë dhe zbatimin e vendimeve që merr asambleja.

4. Inspektimi në fushën e ndërtimit kryhet nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik, në nivel bashkie/komune, sipas kompetencave të përcaktuara për këto struktura, në përputhje me ligjet nr.9780, datë 16.7.2007 dhe nr.10 112, datë 9.4.2009 dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

5. Kur gjatë kontrollit të objekteve në bashkëpronësi konstatohen defekte, prishje, dëmtime, që përbëjnë rrezik për shembje totale (si ndërhyrje në themele ose mure mbajtëse) apo të pjesëve të

veçanta (si p.sh., ballkone apo pjesë suvaje), zënie të kalimeve apo vendparkimeve të përbashkëta, prani të faktorëve që përbëjnë rrezik për jetën e banorëve (si p.sh., pika të mbushjes së bombolave të gazit etj.) apo veprimtari që mund të bëhen shkak për prishje të qetësisë e rehatisë, për përhapje epidemie, për aroma të pakëndshme, dëmtim të shëndetit, a raste të ngjashme, inspektori rekomandon zgjidhjet, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim dhe në ligje specifike, si ligji nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

6. Në sistemet dhe elementet që do të kontrollohen, ndërmjet të tjerave, përfshihen:

- a) themelet e ndërtesës, kur katet nën tokë janë të shfrytëzueshme;
- b) elementet strukturore, në rastet kur janë bërë ndërhyrje të miratuara nga asambleja e bashkëpronarëve dhe pa projekt;
- c) elementet e jashtme, si: suvatimi i jashtëm, lyerja e fasadës, shenja të rrjedhjeve të tubacioneve në fasada;
- ç) elemente të dëmtuara të sistemit të çatisë ose tarracës, që përbëjnë rrezik shembjeje;
- d) elementet e sistemit elektrik nga kuadri qendror deri te degëzimi në njësinë individuale;
- dh) elementet e impianteve të instaluar në ndërtesë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:

- sistemin e furnizimit me ujë;
- shkarkimin e ujërave të zeza;
- e) depozita e ujit të pijshëm;
- ë) veprimtaria e njësive që nuk shërbejnë për banim.

7. Inspektimi nuk do të kryhet duke hyrë:

- a) në ndonjë zonë ose për të kryer ndonjë procedurë që është e pasigurt dhe mund të jetë e rrezikshme për inspektorin ose personat e tretë;
- b) në ndonjë zonë ose për të kryer ndonjë procedurë që mund të dëmtojë pronën në tërësi, sistemet e saj ose elemente të veçanta, njerëzit etj.

8. Çdo procedurë inspektimi fillon me nismën e organit inspektues, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga kryesia e asamblesë së bashkëpronarëve ose të kërkesës së çdo pronari të interesuar dhe që ka shkak të ligjshëm mbi bashkëpronësinë përkatëse. Organet e inspektimit, në përmbushje të përgjegjësisë të tyre, mbështeten nga policia e bashkisë/komunës.

9. Inspektimi kryhet në bazë të planit të inspektimit. Njoftimi për kryerjen e inspektimit bëhet me shkrim nga inspektorati vendor, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së caktuar për kryerjen e këtij inspektimi dhe i drejtohet administratorit/shoqërisë së administrimit e kryetarit të asamblesë së bashkëpronarëve.

10. Në njoftim përcaktohen:

- a) lloji i sistemeve dhe elementeve, subjekt i kontrollit;
- b) arsyeja e kontrollit;
- c) data dhe ora e kryerjes së kontrollit;
- ç) grupi dhe kohëzgjatja e inspektimit.

11. Një kopje e njoftimit vendoset në kutinë postare të administratorit dhe në mungesë të saj i dorëzohet në dorë, përkundrejt nënshkrimit, njërit prej subjekteve të mëposhtme:

- a) administratorit;
- b) kryetarit të asamblesë;
- c) njërit prej bashkëpronarëve.

12. Inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar, të lëshuar nga autoriteti përkatës.

13. Inspektorati vendor ndërtimor e urbanistik, me nismën e tij, kryen inspektimin për çështjet e mëposhtme:

- a) kontrollin e themeleve sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 6 të këtij vendimi;
- b) elementet e jashtme të fasadës, sipas përcaktimit të shkronjës “c” të pikës 6 të këtij vendimi;
- c) veprimtarinë e njësive që nuk shërbejnë për banim, sipas përcaktimit të shkronjës “ë” të pikës 6 të këtij vendimi.

14. Kontrolli i themeleve të ndërtesës kryhet vetëm një herë, me nismën e inspektoratit dhe më pas, me kërkesë të asamblesë ose të çdo bashkëpronari, i cili konstaton se në themele janë bërë ndërhyrje.

15. Kontrolli i elementeve të jashtme të fasadës dhe i veprimtarive të njësive që nuk shërbejnë për banim kryhet një herë në vit.

16. Inspektimi i gjendjes teknike të çështjeve sipas shkronjave “b”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 6 të këtij vendimi, bëhet nga inspektorati vendor, me kërkesë me shkrim të asamblesë, administratorit dhe çdo bashkëpronari, në çdo kohë, por jo më shumë se një herë në vit për të njëjtën çështje, përveç rasteve kur nga inspektori është lënë detyrë për riparimin e dëmit.

17. Inspektimi kryhet në prani të kryesisë së asamblesë të bashkëpronarëve dhe të administratorit dhe kur inspektimi është kërkuar nga njëri prej bashkëpronarëve, edhe në prani të tij.

18. Kur qëllimi i inspektimit është verifikimi i defekteve apo dëmeve që i janë shkaktuar pronës së përbashkët apo asaj individuale nga keqpërdorimi, mosfunksionimi apo defekte të pajisjeve të një bashkëpronari tjetër, sipas pikës 3 të nenit 32 të ligjit nr.10 112, datë 27.4.2009, gjatë aktit të inspektimit janë të pranishëm, përveç subjekteve të përcaktuara në pikën 16 të këtij vendimi, edhe pronari i dëmtuar dhe ai që pretendohet se ka shkaktuar dëmin.

19. Në rastet e ndërhyrjeve emergjente të parashikuara në ligjin nr.10 112, datë 27.4.2009, nuk zbatohet afati i njoftimit, i përcaktuar në pikën 9 të këtij vendimi. Konsiderohen raste emergjente, që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, pa njoftim paraprak:

a) shpërthimi i ujërave të zeza, si rezultat i bllokimit të kanalizimit në njërën prej njësive individuale;

b) rrjedhja e furishme e ujit, si rezultat i bllokimit të tubacionit në njërën prej njësive individuale;

c) shpërthimi i zjarrit në njërën prej njësive individuale.

20. Për verifikimin e njërit prej rasteve të sipërpërmendura, inspektorati vendor, nëpërmjet administratorit, kryetarit të asamblesë apo njërit prej bashkëpronarëve që gjendet në objekt, kontakton me pronarin e njësisë ku mendohet se ka ndodhur bllokimi ose shpërthimi. Në rast se pas njoftimit pronari në fjalë nuk përgjigjet, grupi i inspektorëve, në prani të administratorit, kryesisë ose në mungesë të tyre, në prani të jo më pak se 3 (tre) bashkëpronarëve të tjerë, bën çeljen e detyruar të njësisë, duke mbajtur procesverbal për veprimet e kryera, i cili nënshkruhet nga të gjithë personat e pranishëm.

